

REPUBLICA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLES SE PARE E JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM

TIRANË

NR 554 AKTI

NR 5707/4 VENDIMI

Datë regjistrimi 01.03.2023

Dt 28.12.2023

VENDIM

MBI DEPOZITIMIN E AKTEVE NE RREGJISTRIN E ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURESE

Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tiranë, e përbërë nga:

ANTONELA PRENDI –GJYQTARE

sot më datë 28.12.2023 mori në shqyrtim, ne dhome këshillimi, kërkesën civile me nr 554 Akti, që i përket:

KERKUES : Federata Shqiptare e Sportit Universitar, perfaqesuar nga Presidenti Besnik Veliu.

OBJEKTI : Regjistrimi i vendimeve te Asamblese se Federates Shqiptare te Sportit Universitar dt 17.02.2023.

BAZA LIGJORE : Ligji nr 8788, dt 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurese”.


Gjykata pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën dhe aktet bashkëngjitur saj

VËREN

Me vendimin nr 5707, dt 21.12.2017 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur rregjistrimi i shoqates “ Federata Shqiptare e Sportit Universitar” me themelues : Shoqata Sportive Studentore e Universitetit te Tiranes, Shoqata Sportive Studentore e Universitetit Ismail Qemali, Shoqata Studentore e Universitetit “ Eqerem Cabej “ Gjirokaster, Shoqata Studentore e Universitetit “ Aleksander Moisiu”, Shoqata Studentore e Universitetit Politeknik te Tiranes. Organet drejtuese te FSHSU jane Asambleja e Pergjithshme e Anetareve, Presidenti dhe Komiteti Drejtues me kompetenca te percaktuara ne statut.

Ne vijimesi ne rregjistrin e OJF –ve jane depozituar vendimet e organeve drejtuese te shoqates mes te cilave dhe shtimi i anetareve te rinj me shoqatat e meposhtme :

- Shoqata sportive studentore e Universitetit te Sporteve Tirane
- Shoqata sportive studentore e Universitetit “ Marin Barleti” Tirane
- Shoqata sportive studentore e Universitetit Bujqesor Tirane
- Shoqata sportive studentore e Universitetit “ Luigj Gurakuqi” Shkoder
- Shoqata sportive studentore e Universitetit “ Luarasi “ Tirane
- Shoqata sportive studentore e Univerisitetit “ Fan Noli “ Korce.



Me vendimin nr 2, dt 11.01.2023 Komiteti Drejtues i Federates Shqiptare te Sportit Universitetit vendosi zhvillimin e mbledhjes se Asamblese me dt 17.02.2023 me rend dite :

- verifikimi i perberjes se mbledhjes;
- miratimi i Komisionit Zgjedhor ;
- prezantimi i Komiteteve te FSHSU ne 5 vite;
- hapja e procesit te votimit per Presidentin e ri te FSHSU ;
- hapja e procesit te votimit per anetaret e rinj te Bordit Drejtues te FSHSU ;
- shpallja e rezultatit te votimeve;
- mbyllja e Asamblese.

Me dt 17.02.2023 eshte zhvilluar Mbledhja e Asamblese se FSHSU-se dhe vendimet e marra jane pasqyruar ne procesverbalin e mbajtur per kete mbledhje.

Pjesemarres ne mbledhje kane qene anetaret e meposhtem te FSHSU –se :

1. Shoqata Sportive Studentore UAMD ;
2. Shoqata Sportive Studentore UBT ;
3. Shoqata Sportive Studentore “ Eqerem Cabej”
4. Qendra FAB ;
5. Qendra Sportive Studentore “ Ismail Qemali” ;
6. Shoqata Sportive Studentore “ Barleti”
7. Shoqata Sportive Studentore “ Luigj Gurakuqi” ;
8. Shoqata Sportive Studentore UPT;
9. Shoqata Sportive Studentore UST ;
10. Shoqata Sportive Studentore UT.

Secili anetar ka caktuar perfaqesuesit e tij per te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese referuar dokumentacionit te paraqitur nga pala kerkuese.

-Me vendimin nr 1, dt 17.02.2023 te Asamblese se Federates Shqiptare te Sportit Universitar u zgjodhen me vota unanime anetaret e Komisionit Zgjedhor te FSHSU :

Kryetar – Lorenc Kociu

Anetare – Mimoza Tare

Anetar – Pavli Karaja

-Me vendimin nr 2 dt 17.02.2023 te Asamblese se Federates Shqiptare te Sportit Universitar

u zgjodh President i FSHSU z. Besnik Veliu (25 vota pro dhe 2 vota te pavlefshme).

- me vendimin nr 3, dt 17.02.2023 te Asamblese se Federates Shqiptare te Sportit Universitar u zgjodhen anetaret e Komitetit Drejtues te FSHSU :

Gjergji Iliadhi (23 vota)
Arjan Pano (25 vota)
Taulant Hoxha (24 vota)
Tauland Spahiu (22 vota).

Vendimet e mesiperme te Asamblese dt 17.02.2023 te Federates Shqiptare te Sportit Universitar kerkohen te depozitohen ne rregjistrin e OJF-ve prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen cmon se eshte e bazuar ne ligj dhe ne statutin e shoqates dhe per kete shkak vendos pranimin e saj.

Kompetencen per te zgjedhur Presidentin dhe anetaret e Komitetit Drejtues e gezon Asambleja e Pergjithshme e FSHSU :

Neni 14

“ Asambleja ka keto kompetenca :

7.zgjedh Presidentin e Federates.

8.zgjedh anetaret e Komitetit Drejtues.

Secili prej anetareve te shoqates ka te drejte te zgjedhe perfaqesuesit me te drejte vote ne mbledhjen e Asamblese (neni 15 i statutit). Numri i delegateve per secilin anetar percaktohet ne nenin 16 te statutit. Asambleja e Pergjithshme thirret nga Komiteti Drejtues referuar nenit 19 te statutit. Asambleja mund te marre vendime kur jane te pranishem me shume se gjysma e delegateve me te drejte vote. Vendimet merren me 50 % +1 te votave te delegateve te pranishem ne mbledhje (neni 20 dhe 22).

Dispozitat e mesiperme statutore, ne lidhje me quorumin dhe shumicen vendimmarrese rezultojne te jene respektuar ne vendimmarrjet e Asamblese se Federates Shqiptare te Sportit Universitar dt 17.02.2023. Nga 11 anetare te shoqates ne mbledhje kane marre pjese 10 anetare permes perfaqesuesve te tyre, te zgjedhur ne respektim te kuotave te delegateve sipas percaktimeve te statutit.

Ne konkluzion pasi shqyrtoi kerkesen gjykata cmon se eshte e bazuar ne ligjin nr 8788, dt 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe per kete shkak vendos pranimin e saj

PËR KËTO ARSYE

Bazuar ne ligjin Nr. 8788, date 7 Maj 2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar”

VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës.

2. Depozitimn në regjistrin e organizatave jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të :

- vendimit nr 1, dt 17.02.2023 të Asamblesë së Federatës Shqiptare të Sportit Universitar në të cilën u zgjedhën anetare të Komisionit Zgjedhor të FSHSU :

Kryetar – Lorenc Kociu

Anetare – Mimoza Tare

Anetar – Pavli Karaja

-vendimit nr 2 dt 17.02.2023 të Asamblesë së Federatës Shqiptare të Sportit Universitar në të cilën u zgjedh President i FSHSU-se z. Besnik Veliu.

- vendimit nr 3, dt 17.02.2023 të Asamblesë së Federatës Shqiptare të Sportit Universitar në të cilën u zgjedhën anetarët e Komitetit Drejtues të FSHSU :

Gjergji Iliadhi

Arjan Pano

Taulant Hoxha

Tauland Spahiu.

3. Pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në skedën përkatëse të Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tirane me dt 28.12.2023

GJYQTARE

ANTONELA PRENDI

